



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Data e miratimit të vendimit: 09-07-2014			
Titulli i vendimit	Numri i vendimit	Shprehja e vendimit	Vlerë
01-013/982			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazetës Zyrtare nr. 28/2008 dhe nenit 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 30.06.2014, aprovon këtë:

V E N D I M

për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtatores së ish diplomatit amerikan Richard Holbrooke

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, CAKTON lokacion për ngritjen e shtatores së ish diplomatit Amerikan Richard Holbrooke, mikut të madh të shqiptarëve, i cili vuri në lëvizje procese të mëdha politike në Ballkan, veçanërisht me çështjen shqiptare dhe Kosovën në veçanti.

Neni 2

Vendi për ngritjen e shtatores nga neni 1 i këtij vendimi caktohet përball "NLB Prishtina" në pjesën perëndimore, përkatësisht në parcelën kadastrale nr 3115-2 e cila gjendet në pronësi të Komunës së Vitisë dhe ka një sipërfaqe prej 170m² me dimensione të ofruara nga Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 3

Ky Vendim është miratuar nga Kuvendi i Komunës në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës së Vitisë duke u bazuar në ndihmën e madhe që ky kolos (Richard Holbrooke) ka bërë për lirinë e popullit të Kosovës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. DKPGJ-së,
2. DKRS-së, dhe
3. Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit:

Naim Pira

